

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët dhe stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani për semestrin e dytë të vitit akademik 2016-2017.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë por ata duhet të jenë të paktën të regjistruar në vitin e dytë të studimeve të tyre.)
- **Master** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin e Tiranës.)
- **Doktoraturë** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi të doktoraturës në Universitetin e Tiranës.)

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor, Master, Doktoraturë (5 muaj)
- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (minimumi 8 orë mësimdhënie në javë, 5 ditë + 2 ditë udhëtim)

Fushat e studimit:

- Histori dhe arkeologji
- Filozofi dhe etikë
- Edukim
- Gjuhë të huaja

- Shkenca sociale dhe të sjelljes (shkenca politike, sociologji, dhe studime kulturore, psikologji)
- Gazetari dhe raportim
- Biznes dhe administrim (menaxhim dhe administrim, kontabilitet, financë, ekonomiks, marketing)
- Drejtësi
- Shkenca të Biologjisë (biologji, biokimi)
- Shkenca të fizikës (kimi, fizikë, shkencat e tokës)
- Matematikë dhe statistikë
- Teknologji informacioni dhe komunikimi

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj për studentët/140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Për më shumë informacion vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/funding>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Ju lutem vizitoni linkun <https://erasmusplus.uaic.ro/documents-to-be-uploaded> për t'u informuar rreth dokumentave që ju duhen për aplikim.

Vini re se për të gjitha certifikatat/diplomat/listat e notave duhet bërë upload versioni origjinal i skanuar si edhe përkthimi i autorizuar në gjuhën angleze (në rast se origjinali nuk është lëshuar në gjuhën angleze).

Një ndër dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët është dokumenti Learning Agreement.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: 20 Janar 2017

Për të aplikuar ju lutemi vizitoni <https://erasmusplus.uaic.ro/wp-login.php?action=register>

Gjithë aplikimi është online.

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni
<https://erasmusplus.uaic.ro/> ose mund të na kontaktoni në adresën
iro@unitir.edu.al

Autoritet përgjegjëse për firmosjen e dokumentit Learning Agreement në nivel fakulteti janë:

1- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Znj. Albana (Çoni) Shijaku

2- Fakulteti i Drejtësisë

Znj. Kestrin Katro - për nivelin BA

Z. Erjon Muharremaj për nivelin MA dhe PhD

3- Fakulteti Ekonomik

Z. Ervin Demo

4- Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Cikli i studimit	Programi i studimit	Autoriteti përgjegjës
Bachelor	Biologji	Znj. Mirela Lika
Bachelor	Bioteknologji	Znj. Klementina Puto
Bachelor	Matematikë	Z. Artur Baxhaku
Bachelor	Fizikë	Z. Polikron Dhoqina
Bachelor	Informatikë	Z. Endri Xhina
Bachelor	Kimi	Znj. Kozeta Vaso
Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	Znj. Rozana Troja
Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	Znj. Rozana Troja
Bachelor	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	Z. Fatmir Hoxha

Bachelor	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Z. Endri Xhina
Master i Shkencave	Biologji Mjedisore	Znj. Mirela Lika
Master i Shkencave	Biologji Molekulare	Znj. Mirela Lika
Master i Shkencave	Fizikë	Z. Polikron Dhoqina
Master i Shkencave	Biologji Molekulare dhe Industriale	Znj. Klementina Puto
Master i Shkencave	Kimi Industriale dhe Mjedisore	Znj. Rozana Troja
Master i Shkencave	Inxhinieria e Proceseve Kimike	Znj. Rozana Troja
Master i Shkencave	Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore	Znj. Rozana Troja
Master i Shkencave	Kimi	Znj. Kozeta Vaso
Master i Shkencave	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	Z. Fatmir Hoxha
Master i Shkencave	Informatikë	Z. Endri Xhina
Master i Shkencave	Matematikë	Z. Artur Baxhaku
Master i Shkencave	Mësues në Kimi për Arsimin e Mesëm të Lartë	Znj. Kozeta Vaso
Master i Shkencave	Mësues në Biologji për Arsimin e Mesëm të Lartë	Znj. Mirela Lika
Master i Shkencave	Mësues në Fizikë për Arsimin e Mesëm të Lartë	Z. Polikron Dhoqina
Master i Shkencave	Mësues në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë	Z. Artur Baxhaku
Master i Shkencave	Mësues në Informatikë për Arsimin e Mesëm të Lartë	Z. Endri Xhina
Master i Shkencave	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	Z. Endri Xhina
Master Profesional	Bioteknologji Mjedisore	Znj. Klementina Puto

Master Profesional	Informatikë Biznesi	Z. Endri Xhina
Master Profesional	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	Z. Fatmir Hoxha
Master Profesional	Menaxhimi i Teknologjive të Informacionit	Z. Endri Xhina

5- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Z. Andi Pinari

6- Fakulteti i Shkencave Sociale

Z. Blendi Çeka për nivelin BA dhe PhD

Znj. Orinda Maltezi për nivelin e MA

7- Instituti i Studimeve Evropiane

Znj. Ilira Sulo (Drejtor i Institutit të Studimeve Evropiane)

Ju urojmë suksese në aplikimin tuaj!